



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË


2016-2020




Përcashtim



Integrim



Përfshirje



Segregim



EUROPEAN UNION



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe ministrinë e linjës në konsultim të ngushtë me përfaqësues të autoriteteve vendore, organizatave ndërkombëtare, me kontributin e përfaqësuesëve të shoqërisë civile përfshirë edhe organizatat rome dhe egjiptiane, ekspertë të fushës si dhe me pjesëmarrjen aktive të ekspertëve romë dhe egjiptianë.

Ekspertizë dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Projekti “Mbështetje për Përfshirjen Sociale të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane – SSIREC” financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Agjensia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – PNUD në partneritet me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Dhjetor 2015





Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 Datë 23.12.2015, vjen si një dokument i rëndësishëm i Qeverisë. Ai është tërësisht i mbështetur, jo vetëm në parimet bazë të Kushtetutës së Shqipërisë por edhe në parimet themelore të antidiskriminimit të të gjitha Konventave Ndërkombëtare.

Ky Plan, përfshin politika specifike dhe masa konkrete, që institucionet përgjegjëse do të ndërmarrin në realizimin e objektivave, në sektorët respektivë dhe programet publike, që synojnë të përmirësojnë jetesën e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri.

Dëshiroj të theksoj se, për herë të parë kemi në dorë një Plan masash konkrete të kostuar më së miri e të shoqëruar me një analizë buxhetore në përputhje me Planifikimin Buxhetor Afatmesëm dhe pa dyshim në mbështetjen financiare që na japin partnerët tanë ndërkombëtarë.

Sipas kostimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, pjesë të këtij dokumenti, rezulton se rreth 60% e fondeve të nevojshme për zbatimin e masave, do të mbulohej nga buxheti i shtetit, duke përbushur në këtë mënyrë edhe rekomandimet e BE.

Jemi të kënaqur që procesi i hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve ka qenë gjithëpërfshirës në çdo hap të hedhur, e ku çdo masë e këtij Plani vjen si adresim i nevojave të sjella nga terreni e të prezantuara nga përfaqësuesit e organizatave Rome dhe Egjiptiane. Gjej rastin të falënderoj të gjithë organizatat e shoqërisë civile për kontributin e tyre të vlefshëm.

Për përfundimin me sukses të këtij procesi, që është jashtëzakonisht i rëndësishëm, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dëshiron të falënderojë Zyrën e Kryeministrit, Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Zhvillimit Urban, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Çështjeve Vendore, Komisionin e Ndihmës Ligjore, Shërbimin Social Shtetëror, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, Institutin e Shëndetit Publik dhe Institutin Shqiptar të Statistikave.

Një falenderim i veçantë shkon për partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht PNUD-in, për ndihmesën e tyre në finalizimin e këtij dokumenti të rëndësishëm dhe Komisionin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme në favor të integritit të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në Shqipëri.

Ne presim të vazhdojmë bashkëpunimin tonë me partnerët e zhvillimit e sigurisht me shoqërinë civile veçanërisht me organizatat rome dhe egjiptiane, në kontekstin e zbatimit të këtij Plani Kombëtar Veprimi.

Blendi KLOSI



Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë





Tabela e Përmbajtjes



TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	7
I – HYRJE	11
II – METODOLOGJIA	17
III – PJESEMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT	21
Ministritë e linjës	21
Shoqëria civile duke përfshirë organizatat rome dhe egjiptiane	21
IV – KUSHTET AKTUALE	25
Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë	25
Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor	28
Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)	29
Kujdesi shëndetësor	32
Strehimi dhe integrimi urban	34
Mbrojtja sociale	38
V– VIZIONI DHE QELLIMET STRATEGJIKE	43
VI – OBJEKTIVAT E POLITIKES	47
VII – KUADRI VLERESUES DHE MONITORUES	51
VIII – BURIMET FINANCIARE	57
IX – MATRICA E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT	61





Shkurtesat



SHKURTESAT

ADN	Acidi Desoksiribonukleik
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
AP	Autoritetit Përgjegjës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
CAHROM	Komiteti i Posaçëm i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Çështjet e Komunitetit Rom
DPSBGJ	Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
DRSH	Drejtoria Rajonale e Shendetit
EUR	Euro
ECRI	Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
ID	Dokument identifikimi
INSTAT	Instituti i Statistikave i Republikës së Shqipërisë (Instituti i Statistikave)
IKT	Instituti i Kurrikulës dhe Trainimit
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KE	Komisioni Evropian



MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MK	Ministria e Kulturës
MF	Ministria e Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Veprimit
MM	Ministria e Mjedisit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NJMF	Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
OJF	Organizatë jo-fitimprurëse
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
QFP	Qendra e Formimit Profesional
SSIREC	Projekti “Mbështetja për përfshirjen sociale të komunitetit rom dhe egjiptian”
SIVET	Sistemi i Informacionit për Vikekimat e Trafikimit
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
PSV	Procedurat Standarte të Veprimit
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
USD	Dollar amerikan
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZA	Zyra Arsimore







I Hyrje



I – HYRJJE

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve është një dokument i hartuar nga qeveria shqiptare dhe nën koordinimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ky Plan është një angazhim i ri me kohështirje 2016-2020, i cili targeton dy komunitetet përkatëse, paraqet një përshkallëzim të masave të zbatuara dhe në zbatim dhe parashikon gjithashtu nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen e integritit të romëve dhe egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2016-2020 dhe mundësinë e financimit nëpërmjet koordinimit me ndihmën e huaj. Plani i Veprimit është hartuar në konsultim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti Rom dhe Egjiptian si dhe aktorë të tjerë.

Pas marrjes së statusit të vendit kandidat në BE në vitin 2014, qeveria shqiptare intensifikoi reformat e nevojshme për aderimin e saj, përfshirë edhe nxitjen e aksesit të barabartë në shërbime dhe të të drejtave të barabarta për të gjithë shtetasit. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë i kushtohet masave që mund të shembin barrierat me të cilat përballen romët dhe egjiptianët sa i përket aksesit në shërbime, përmirësimit të kushteve të tyre të jetesës nëpërmjet integritit dhe nxitjes së dialogut ndërkulturor.

Në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE, qeveria shqiptare ka miratuar tashmë disa dokumenta, sic janë Plani Kombëtar i Integritit European 2015-2020, Udhërrëfytyri për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, “masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”¹. Përbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfytyrin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: rregjistrimi civil, aksesit në drejtësi, arsimi, dialogu ndërkulturor, punësimi dhe përmirësimi i aftësive, kujdesi shëndetsor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale. Janë pikërisht këto fusha që kanë orientuar objektivat kryesore të përcaktuara në këtë dokument. Gjithashtu duke marrë parasysh angazhimet e përshkruara në dokumentin Udhërrëfytyri Plani i Veprimit jep një listë më të detajuar të aktiviteteve që do të zbatohen gjatë periudhës 2016-2020.

1 Bashkimi Evropian, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.

Sot në Shqipëri njihet minoriteti etno-linguistik Rom dhe nga ana tjetër komuniteti Egjiptian. Nga regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në vitin 2011 u identifikuan vetëm 8.300 romë dhe 3.368 egjiptianë. Të dhëna të tjera nga studime të ndryshme raportojnë për 18.276² deri në 120.000 romë³ dhe supozohet për më shumë se 200.000 egjiptianë⁴, gjë që e bën përfshirjen e tyre social-ekonomike me rëndësi për zhvillimin e përgjithshëm të vendit⁵.

Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përrjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin diskriminues në disa raste nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja⁶. Tridhjetë e nëntë për qind e banesave të romëve dhe 21 për qind e atyre ku banojnë egjiptianët nuk furnizohen me ujë të pijshëm⁷. Mesatarisht romët kanë një moshë vdekjeje të paktën dhjetë vjet më të re sesa popullsia tjetër jorome dhe kanë shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore⁸.

2 Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014, http://www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf. Ky numër është vetëm për Romët që jetojnë në zona të përqëndruara.

3 Përllogaritje të siguruara nga shoqata rome "Amarodrom", të cituara në raportin e Bankës Botërore Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Nga përjashtimi social në përfshirjen sociale, i përgatitur nga Hermine De Soto, Sabine Beddies dhe Ilir Gedeshi, 2005, <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/7313/32181.pdf?sequence=1>, f. xxiv.

4 Po aty, përllogaritje e siguruar nga shoqata egjiptiane "Vëllazërimi".

5 Romët në Shqipëri njihen si minoritet gjuhësor, që është një status i nivelit të dytë krahasuar me minoritetet kombëtare (grekët, malazezët dhe maqedonasit). Ndryshe nga romët, egjiptianëve nuk u është dhënë status minoriteti me arsyetimin se ata nuk e kanë ruajtur identitetin e tyre (si p.sh. gjuhën) dhe e identifikojnë veten si shqiptarë. Romët dhe egjiptianët janë dy komunitete të marginalizuara dhe që vuajnë përjashtimin social. Në Rishikimin Periodik Universal të vitit 2014, Shqipëria raportoi se "një grup pune ndërinstitutional po punon për rishikimin e kuadrit ekzistues legjislativ dhe institucional dhe për trajtimin e ankesave nga minoritetet. Grupi i punës ka përgatitur një analizë të plotë të legjislacionit dhe politikave të qeverisë që afektojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë pakicat që jetojnë në Shqipëri. Gjithashtu analiza përmban edhe rekomandime për ndërhyrje në legjislacionin aktual"

6 Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome, Raporti i monitorimit nga shoqëria civile për zbatimin e strategjisë kombëtare të integritit të komunitetit rom dhe të planit të veprimit të dekadës rome në vitin 2012 në Shqipëri, i përgatitur nga grupi i autorëve (Bajrami, Ivia; Cabiri, Ylli; Hasantari, Adriatik; Kazanxhiu, Latif; Koci, Renart; Mustafaj, Enver; Myrteli, Laver; Nuredin, Albana; Pegini, Hafize; Rama, Lindita; Rushiti, Selvie; Xega, Gerta; Ziu, Dritan), i publikuar në maj 2013, http://www.issuealab.org/click/download2/civil_society_monitoring_report_on_the_implementation_of_the_national_roma_integration_strategy_and_decade_action_plan_in_2012_in_albania, f. 20.

7 Të dhëna nga studimi social-ekonomik UNDP/WB/EC 2011, të cituara në raportin e PNUD-it për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, f. 24-25.

8 Komisioni Evropian, Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, prill 2014, http://ec.europa.eu/health/social_determinants/docs/2014_roma_health_report_en.pdf, f. 37.



Romët dhe egjiptianët përfundojnë mesatarisht 5-6 vjet arsim, krahasuar me mesataren kombëtare që është 10 vjet⁹.

Parimet që udhëheqin Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve¹⁰ janë:

1. Nxitja e përfshirjes sociale – Aktivitetet e Planit të Veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t'u përdorur nga këto komunitete.
2. Përdorimi i një qasjeje të targetuar/ synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit – Plani i Veprimit propozon gjithashtu masa të targetuara për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës që nuk mund të trajtohen përmes burimeve të përgjithshme. Ndërhyrjet e targetuara nuk do të krijojnë diskriminim (p.sh., përmes strehimit apo klasave të ndara për romët dhe egjiptianët), por synojnë të lidhin romët dhe egjiptianët me sistemin e përgjithshëm dhe të përmirësojnë aksesin e tyre në shërbimet publike ekzistuese.
3. Respektimi i dallimeve – Plani i Veprimit respekton dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. Plani i Veprimit trajton anëtarët vulnerabël të këtyre komuniteteve, duke njohur faktin që disa romë dhe egjiptianë janë tashmë të integruar në shoqëri.
4. Vënia e theksit mbi angazhimin e romëve dhe egjiptianëve – Plani i Veprimit përfshin mekanizmat për angazhimin e romëve dhe egjiptianëve në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike.
5. Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm – Krijimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit bazohet në bashkëpunimin midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, shoqërisë civile, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vet komuniteteve.
6. Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale – Plani i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale, regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.
7. Matja e progresit – Plani i Veprimit është i pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë (nga ku do të nisë puna) kur është e mundur.
8. Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor – Plani i Veprimit pranon faktin se gratë romë dhe egjiptiane kanë më tepër gjasa të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor. Dokumenti bën gjithashtu thirrje për mbledhjen e të dhënave të disagreguara sipas

⁹ Statistikat për romët dhe egjiptianët vijnë nga Anketa social-ekonomike me romët dhe egjiptianët, 2011, ndërsa mesatarja kombëtare është marrë nga raporti i regjistrimit të popullsisë 2011 nga INSTAT Popullsia e Shqipërisë.

¹⁰ Këto parime u frymëzuan nga Parimet e përbashkëta bazë për përfshirjen e romëve të BE-së në 2009, që gjenden në http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Documents/2011_10_Common_Basic_Principles_Roma_Inclusion.pdf.

gjinisë për çdo tregues përkatës.

9. Buxheti për zbatimin – ministritë e linjës kanë identifikuar një buxhet për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar edhe hendeqet e financimit ku mund të kërkohet ndihmë nga donatorë.







II Metodologjia



e informimit, dokumentat strategjik përkatës, si dhe fondet e nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit. Matrica u nda në gjashtë sektorë prioritarë, specifikisht:

- Regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi
- Arsimit dhe promovimi i dialogut ndërkulturor
- Punësimi dhe arsimit e formimi profesional (AFP)
- Kujdesi shëndetësor
- Strehimi dhe integrimi urban
- Mbrojtja sociale

Masat e Planit të Veprimit në këto fusha janë të bazuara në nevojat e romëve dhe egjiptianëve të identifikuar nëpërmjet të dhënave bazë dhe anketimeve, por gjithashtu ato janë bazuar edhe në mundësitë e burimeve dhe kapacitetet e qeverisë për t'iu përgjigjur këtyre masave.


Gjatë procesit të hartimit janë organizuar një seri takimesh prezantuese të drafteve të realizuara, të koordinuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të cilat u vijuan me seminare sektoriale në bashkëpunim me ministrinë e linjës si më poshtë:

- Ministria e Kulturës
- Ministria e Arsimit dhe Sporteve
- Ministria e Shëndetësisë
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Zhvillimit Urban
- Ministri për Çështjet Vendore, me përfaqësues të këshillave rajonale dhe të Bashkive kryesore.

Një takim i veçantë është mbajtur me Ministrinë e Financave në lidhje me buxhetimin.

Gjithashtu, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka organizuar takime me organizata që promovojnë barazinë gjinore, zyrën e Ministrit të Inovacionit dhe Administratës Publike dhe Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Konsultime ka patur edhe me Ministrinë e Mjedisit dhe atë të Punëve të Jashtme sa i përket aktiviteteve specifike të Planit të Veprimit për të cilat do të jenë përgjegjëse këto ministri.





Pjesëmarrja e Grupeve të Interesit



III – PJESËMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020 është hartuar me kontributin e dhënë nga grupi teknik i punës i koordinuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me anëtarë dhe ekspertë të ardhur nga ministrinë përkatëse të linjës dhe shoqëria civile. Gjatë hartimit të Planit të Veprimit janë konsultuar gjithsej mbi 200 individë nga grupet e interesit.

Ministrinë e linjës

Pas takimeve prezantuese me ministrinë përkatëse të linjës, u organizua një seminar sektorial i posaçëm nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me ministri të tjera të linjës dhe në bashkëpunim me përfaqësues nga shoqëria civile rome dhe egjiptiane. Grupet e punës identifikuan nevojat dhe hartuan synimet, objektivat dhe aktivitetet në secilin sektor. Në vijim u organizuan konsultime me ministrinë e linjës për mbledhjen e të dhënave bazë dhe përcaktimin e buxhetit.

Pushteti vendor

Përfaqësues nga këshillat e qarqeve dhe Bashkitë kryesore morën pjesë në dy takime të organizuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunimin e Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore. Konsultimet me autoritetet vendore përfshinë edhe një vizitë në terren në bashkinë e Beratit dhe takime me koordinatorët romë dhe egjiptianë në bashkinë e Tiranës.

Shoqëria civile duke përfshirë organizatat rome dhe egjiptiane

Në 5 seminarët sektoriale të zhvilluara, së bashku me ministrinë e linjës morën pjesë përfaqësues të organizatave rome dhe egjiptiane, përfaqësuesi rom i Komitetit Shtetëror për Minoritetet, ekspertë rom dhe egjiptian që punojnë në institucione të pavarura të cilët shprehën gjithashtu këndvështrimet e tyre në diskutimet me grupet e fokusuara. Katër të sapo diplomuar rom dhe egjiptian u përfshinë si pjesë aktive e ekipit të konsulentëve që lehtësuan konsultimet, si dhe mbështetën hartimin e Planit të Veprimit.

Në takimin që Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë organizoi me përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, ata dhanë informacione rreth aktiviteteve të tyre në të shkuarën dhe atyre aktuale, të cilat kanë shërbyer si frymëzim për disa nga masat e Planit të Veprimit. Këto organizata kanë dhënë gjithashtu një përshkrim të aktiviteteve që planifikojnë të kryejnë gjatë



periudhës 2016-2020. Anketat dhe studime të tjera të publikuara nga organizatat ndërkombëtare në Shqipëri kanë qenë tepër të vlefshme për hartimin e Planit të Veprimit, për argumentimin dhe për përcaktimin e përparësisë së masave të ndryshme.







IV

Kushtet Aktuale



IV – KUSHTET AKTUALE

Seksioni në vijim përshkruan sfidat me të cilat përballet komuniteti rom dhe ai egjiptian në fushat e trajtuara nga ky Plan Veprimi për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, dhe më konkretisht:

Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë

Romët dhe Egjiptianët, hasin vështirësi dhe kanë probleme në lidhje me regjistrimin civil, sidomos për fëmijët romë. Kjo për rastet e lindjeve në institucionet shëndetësore dhe ato jashtë institucioneve, brenda dhe jashtë vendit. Ky fakt sjell pengesa në pajisjen me dokumente të shërbimit të gjendjes civile dhe kur plotëson moshën edhe me dokumente identiteti. Romët dhe më pak egjiptianët hasin barriera në shërbimin e gjendjes civile në rastet e ndryshimit të vendbanimit, për shkak të mungesës së certifikatës së pronësisë ose të kontratës së qirasë së banesës në bashkinë ku janë shpërngulur. Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë kontribut të rëndësishëm nëpërmjet rekomandimit për: “Marrjen e masave për rregjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom, në regjistrat e gjendjes civile në njësite vendore ku ata kanë vendbanimin aktual”

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile

në vitin 2014¹¹ u regjistruan 148 fëmijë nga komuniteti Rom si regjistrime të vonuara dhe u identifikuan rreth 500 raste të individëve romë që kanë nevojë për ndihmë të lloje të ndryshme për regjistrimin në gjendjen civile. Vështirësitë në këtë fushë vijnë kryesisht:

- nga mungesa e dokumentacionit të dhënë nga materniteti, për shkak të lindjes jashtë mjediseve shëndetësore. Regjistrimi në gjendjen civile në mungesë të certifikatës së lindjes kërkon ndihmë juridike dhe administrative, të cilën shumica e romëve nuk dinë ku ta marrin dhe nuk mund ta përballojnë financiarisht.
- Regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë shtetit mbetet një sfidë e vështirë pasi prindërit/të interesuarit janë deportuar nga vendet e hapësirës “SHENGEN” e për pasojë nuk mund të sigurojnë vet dokumentet. Kjo gjendje kërkon ndihmë juridike qoftë edhe nëpërmjet shërbimeve konsullore shqiptare që operojnë në këto shtete, që shpesh romët dhe egjiptianët nuk mund t’i përballojnë financiarisht apo t’i ndjekin. Në vitin 2014, Ministria e Punëve të Brendshme identifikoi mbi 200 raste të tilla në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.
- Ndihma juridike/administrative për regjistrimin civil ofrohet kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe shumë rrallë nga shërbimi i ndihmës juridike nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Ligji për Ndihmën Juridike, i miratuar në vitin 2009, garanton shërbimet e ndihmës juridike falas për personat që nuk mund t’i përballojnë ato. Ndihma juridike mund të ofrohet veçanërisht për çështjet e regjistrimit në gjendjen civile, nëse ndonjë rast specifik është veçanërisht kompleks ose personi nuk mund të përballojë pagesën për ndihmën juridike. Gjithsesi, vetëm ata që mund të vërtetojnë se përfitojnë nga ndihma sociale¹², viktimat e dhunës në familje dhe të trafikimit njerëzor e gëzojnë këtë të drejtë¹³. Në këtë kontekst, romët dhe egjiptianët shpesh herë nuk mund të përfitojnë nga sistemi shtetëror.
- Transferimi i vendbanimit kërkon që aplikanti të dorëzojë një certifikatë pronësie ose kontratën e qirasë së një apartamenti/banese që ndodhet në bashkinë ku kërkohet të bëhet transferimi. Shumica e romëve dhe egjiptianëve nuk i kanë këto dokumente, pasi shumë prej tyre jetojnë në kasolle/barraka të improvizuara ose në banesa të palegalizuara. Për rrjedhojë, ata nuk përfitojnë nga shërbimet dhe programet vendore, si p.sh. strehimi social.

Ky fenomen mund të trashëgohet nga njëri brez në tjetrin, duke qenë se prindërit e parregjistruar

11 Të dhëna të Ministrisë së Punëve të Brendshme të ofruara në shtator 2014.

12 Ligji për Ndihmën Juridike, nr. 10039, neni 13, <http://www.tlas.org.al/sites/default/files/file/Ligji%20Ndihmes%20Juridike-Versioni%20i%20miratuar%20nga%20Parlamenti.pdf>.

13 Ndryshimi i Ligjit për Ndihmën Juridike, 2013, neni 4.

do ta kenë të pamundur të rregjistrojnë lindjen e fëmijëve të tyre. Në këtë mënyrë ka gjasa që numri i personave të parregjistruar të rritet , nëse nuk gjendet një procedurë e qëndrueshme për të gjithë sistemin.

Sipas organizatave të shoqërisë civile, “ një pjesë e progresit është arritur përmes ndryshimeve në legjislacion, të cilat lehtësojnë dhe rregullojnë procedurën e rregjistrimit në gjendjen civile, për rastet e rregjistrimit të vonuar. Për këtë qëllim janë ndërmarrë disa ndryshime në Ligjin “ Për gjendjen civile”, si dhe u miratuan disa akte nënligjore që përmirësonin procedurën e rregjistrimit. Megjithatë më shumë punë duhet kryer në fushën e rregjistrimit civil, në identifikimin e rasteve, referimin e tyre deri në rregjistrimin final. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të ndihmojnë në procesin e identifikimit dhe referimit të rasteve.

Varfëria, përjashtimi social dhe tendenca për të mbijetuar me anë të punës informale i bëjnë romët dhe egjiptianët vulnerabël ndaj trafikimit të qenieve njerëzore. Një studim i vitit 2014, tregoi se një e treta e fëmijëve të rrugës rrezikohen nga trafikimi njerëzor dhe mbi 31 raste të trafikimit të fëmijëve iu paraqitën Mekanizmit Kombëtar të Referimit, duke përfshirë ata që kishin vuajtur shfrytëzimin seksual ose që ishin detyruar të lypnin në Shqipëri dhe Kosovë¹⁴.

Ndihma juridike luan një rol të rëndësishëm në përgjigjen ndaj këtyre situatave. Sipas ligjit për ndihmën juridike, Ministria e Drejtësisë harton politikat shtetërore në fushën e shërbimeve të ndihmës ligjore për individët, asiston në përgatitjen e akteve ligjore të nevojshme, parashikon zbatimin e dispozitave ligjore dhe vlerëson cilësinë e ndihmës juridike të ofruar¹⁵. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike punon nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe zbaton politikën shtetërore në dhënien e ndihmës juridike për individët, menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti, përcakton kriteret e vlerësimit të cilësisë së shërbimit dhe bashkëpunon me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në këtë fushë¹⁶.

Pavarësisht këtyre mekanizmave, ndihma juridike falas mbetet gjerësisht e paaksesueshme për romët dhe egjiptianët, sepse ata nuk mund të sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm, veçanërisht dëshmi të vendbanimit të tyre ose të ndihmës ekonomike/të ardhurave dhe Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike ka nevojë për kapacitete dhe burime më të mëdha për t’iu përgjigjur me efikasitet këtyre nevojave.

Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor

14 Studimi u krye në periudhën maj 2013 – shkurt 2014, në kuadër të reformës në shërbimet sociale nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran në Shqipëri dhe ARSIS, i mbështetur nga UNICEF dhe Save the Children.

15 Ligji për ndihmën juridike, nr. 10 039, neni 4.

16 Po aty, neni 10.



Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulëta të regjistrimit në shkollë, alfabetizimit dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%.

Sipas UNICEF, 33,9% e popullsisë rome është nën 14 vjeç dhe për rrjedhojë duhet të ndjekë shkollën¹⁷. Gjithsesi, shumë fëmijë nuk janë regjistruar kurrë dhe përqindja e braktisjes së shkollës është e lartë. Një numër i madh nxënësish rom braktisin arsimin e detyruar jo vetëm si rezultat i qëndrimeve diskriminuese, mungesës së mbështetjes dhe ngacmimeve në shkollë, por edhe për shkak të nevojës për të ndihmuar prindërit e tyre në aktivitete që gjenerojnë të ardhura¹⁸. Sipas studimit të kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), bashkitë më të prekura nga braktisja e arsimit të detyrueshëm janë Tirana, Korça, Elbasani, Fieri, Durrësi dhe Berati¹⁹.

Varfëria dhe kushtet e jetesës ndikojnë drejtpërdrejt në mundësitë e fëmijëve romë dhe egjiptianë për t'u arsimuar. Prindërit që shpesh edhe vetë nuk janë të arsimuar nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre me mësimet, t'u japin udhëzime ose ndajnë përvojën e tyre personale nga kjo periudhë. Më pas, pamundësia për të paguar shpenzimet e jetesës bëhet pengesë për ndjekjen e arsimit më të lartë nga të rinjtë romë dhe egjiptianë. Shpesh ata detyrohen të kërkojnë punë dhe nuk mund ta përballojnë frekuentimin e mësimet me kohë të plotë. Një sërë masash të marra vitet e fundit, duke përfshirë tekstet shkollore falas dhe transportin, vizitat në shtëpi, ndihmën me detyrat e shtëpisë, mësimin e gjuhës dhe seminare për prindërit kanë kontribuar në rritjen e numrit të fëmijëve romë dhe egjiptianë që frekuentojnë shkollën.

UNICEF raporton se “vitet mesatare të frekuentimit të shkollës janë 5,6 vjet për meshkujt [romë] dhe 5,3 vjet për femrat”²⁰. Programi “Shansi i dytë” i prezantuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve është vlerësuar pozitivisht nga organizatat rome dhe egjiptiane dhe është rekomanduar shtrirja e tij në të gjitha shkollat që kanë numër të madh fëmijësh romë²¹. Në të njëjtën kohë, monitorimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi do të jenë të nevojshme për të penguar izolimin dhe për të lehtësuar kalimin e romëve dhe egjiptianëve në sistemin e përgjithshëm.

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 përfshin rishikimin e programit “Shansi i dytë”, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i nxënësve të tij në klasat e rregullta

17 UNICEF dhe Qendra e Studimeve Ekonomike dhe Shoqërore, Hartëzimi i fëmijëve romë në Shqipëri, 2011, http://www.sidalbania.org/Mapping_roma_children_english_may_5_2012.doc, f. 5.

18 Sipas studimit të OSFA-së, 4% e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.

19 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014, www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf

20 UNICEF dhe Qendra e Studimeve Sociale dhe Ekonomike, Identifikimi i fëmijëve romë në Shqipëri, 2011, http://www.sidalbania.org/Mapping_roma_children_english_may_5_2012.doc, f. 6.

21 Fondacioni i Sekretariatit të Dekadës së Përfshirjes Rome, Raporti i monitorimit të shoqërisë civile për implementimin e strategjisë kombëtare të integrimit të komunitetit rom dhe të planit të veprimit të dekadës në vitin 2012 në Shqipëri, maj 2013, f. 41.



dhe që të gjenden mjete të tjera për parandalimin e izolimit.

Gjithashtu, përqindja e ulët e fëmijëve romë dhe egjiptianë që frekuentojnë arsimin parashkollor i gjen ata të papërgatitur për mjedisin shkollor, duke bërë që të mbeten mbrapa dhe duke braktisur përfundimisht shkollën. Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, 42% e fëmijëve romë të moshës 3-6 vjeç frekuentojnë arsimin parashkollor²², krahasuar me afërsisht 50% të fëmijëve në të gjithë vendin²³. Nuk disponohen statistika për fëmijët egjiptianë.

Stafi i mësuesve dhe drejtorët e shkollave duhet të përmirësojnë njohuritë e tyre rreth identitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe të rrisin kapacitetet e tyre për mesimdhënien në një mjedis arsimor shumëkulturor dhe për menaxhimin e tij. Bashkëpunimi midis shkollës, shërbimeve sociale lokale dhe aktorëve të tjerë është i domosdoshëm për trajtimin e problemeve me të cilat përballen fëmijët romë dhe egjiptianë dhe për t'i bërë ata të ndihen të mirëpritur në mjedisin shkollor.

Arsimimi cilësor konsiston jo vetëm në veprimtaritë brenda shkollës, por edhe në aktivitetet në komunitet, ato të ndërgjegjësimit dhe veprimtari të tjera që promovojnë mirëkuptimin e përbashkët dhe dialogun ndërkulturor. Fëmijët romë dhe egjiptianë vuajnë paragjykimet dhe qëndrimet diskriminuese të fshehura, si në mjedisin shkollor, ashtu edhe jashtë tij, gjë që pengon përpjekjet për frekuentimin e shkollës prej tyre dhe më pas integrimin në shoqërinë e gjerë. Në studimin më të fundit të OSFA-së, 80% e familjeve rome kanë raportuar se flasin gjuhën rome në shtëpi (si gjuhë e parë), ndërsa 20% flasin shqip²⁴, kështu që sistemi arsimor duhet të promovojë bilingualizmin ndërkohë që lehtëson përfshirjen. Nevojitet një kombinim mes masave kurrikulare dhe ekstrakurrikulare për nxitjen e dialogut ndërkulturor dhe për krijimin e një mjedisi shkollor përfshirës, ku diversiteti kulturor vlerësohet dhe për rrjedhojë të gjithë fëmijët të ndihen të barabartë pavarësisht identitetit të tyre të ndryshëm kulturor.

Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)

Qeveria zbaton një kombinim të politikave pasive dhe atyre aktive, të cilat nxisin integrimin në tregun e punës. Shërbimi Kombëtar i Punësimit, ofron një paketë programesh punësimi të përshtatshme për romët dhe egjiptianët, megjithatë, pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në këto programe mbetet në nivele minimale. Varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë, ul ndjeshëm interesin e romëve dhe egjiptianëve për të ndjekur shkollat e arsimit profesional, kurset e formimit profesional apo përfshirjen në programe punësimi, si dhe i detyron ata të gjejnë zgjidhje alternative punësimi që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo aktivitetet e tjera

22 Të dhëna të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të siguruar në nëntor 2014.

23 INSTAT, të dhëna të vitit 2005.

24 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014, f. 18.



që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë. Gjithashtu kultura e varfërisë dhe përjashtimit, mungesa e besimit të programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative në të kaluarën etj., bëjnë që pjesa më e madhe e romëve dhe egjiptianëve që punojnë në sektorin informal detyrohen të vazhdojnë të mbeten aty (duke pranuar pasiguritë e tregut informal të punës) dhe nuk preferojnë të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit. Në vitin 2014, qeveria trefishoi Fondin për Punësimin i cili mbulon programet e nxitjes së punësimit deri në vlerën 2,7 milionë USD, pra shtrirja e shërbimeve për komunitetet rome dhe egjiptiane do të jetë thelbësore për të bërë të mundur që ata të përfitojnë nga programet e disponueshme të tregut aktiv të punës.

Nuk ka të dhëna të sakta rreth nivelit të punësimit, të pjesëmarrjes ose të shkallës së papunësisë për romët dhe egjiptianët. Nga studimi i OSFA-së rezultoi se 75% e të rriturve romë në moshë për punë ishin të papunë dhe qytetet më të prekura ishin Elbasani, Berati, Fieri, Gjirokastra, Vlora dhe Lezha²⁵. Për shkak të periudhave të gjata të papunësisë dhe angazhimit të shpeshtë në punë informale dhe me pagë të ulët, familjet rome preken nga varfëria mbi dy herë më shumë sesa familjet jo-rome që jetojnë në afërsi të tyre²⁶. Nuk disponohen të dhëna mbi komunitetin egjiptian.

Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme, ndërsa popullsia egjiptiane është më tepër e përfshirë në sektorin e shërbimeve, të kujdesit familjar dhe të ndërtimit. Punësimi formal bazohet kryesisht në sektorin bujqësor me të cilin sigurohen nevojat bazë (për komunitetet që banojnë në zonat rurale), por që karakterizohet nga parcela të vogla toke, mungesa e infrastrukturës dhe e sistemit ujitës, si dhe nga kostot e larta të mirëmbajtjes²⁷. Nga studimi i PNUD-it për vlerësimin e nevojave rezultoi se 95,9% e të intervistuarve romëve dhe 88,7% e të intervistuarve egjiptianë të punësuar, nuk kishin kontrata pune dhe një raport i njëjtë nuk paguante kontributet shoqërore, gjë që kufizonte aksesin e tyre në mbrojtjen sociale dhe shërbime të tjera²⁸.

Siç u përmend edhe më lart, një numër i madh romësh dhe egjiptianësh punojnë si mbledhës të mbetjeve të riciklueshme, ndonjëherë në burim (p.sh. në restorante), por shpesh edhe nëpër

25 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014.

26 PNUD, Romët në Shqipëri: Profili i vendit në bazë të anketës rajonale për romët të PNUD/BB/KE dhe me të dhëna specifike shtesë për vendin nga "Studimi i vlerësimit të nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri", qershor 2012, <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>, f. 2.

27 PNUD, Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës, Beratit dhe Vlorës, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 29.

28 PNUD, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, f. 41.



kazanët e plehrave dhe në zonat e grumbullimit të mbetjeve. Me privatizimin e mundshëm të landfillleve, shumë prej tyre do të mbeten pa burimin e vetëm të jetesës, nëse nuk gjenden mekanizma për përfshirjen formale të tyre në mbledhjen e privatizuar të mbetjeve dhe në sistemet e klasifikimit të tyre. Gjithsesi, aktualisht nuk ka asnjë program shtetëror për mbështetjen ndaj sipërmarrësve dhe të vetëpunësuarve vulnerabël dhe me nivel të ulët aftësish²⁹, megjithëse qeveria po mendon propozimin e një projekt-ligji për sipërmarrjet sociale. Romët dhe egjiptianët që prodhojnë produkte artizanale tradicionale kanë mundësi të pakta për shitjen dhe reklamimin e tyre, që vjen si rezultat i të ardhurave të kufizuara.

Romëve që jetojnë në zonat rurale shpesh u mungon dokumentacioni i duhur për vërtetimin e pronësisë mbi tokën që është një nga burimet e vetme të jetesës së tyre. Pasiguria e pronësisë buron nga të dhënat kontradiktore mbi pronësinë e tokës në komunat vendore dhe këshillat e qarqeve (zyra kadastrale e qarkut). Në disa raste, për shkak të nevojës imediate për të ardhura, romët shesin tokën pa ndjekur procedurat ligjore. Për rrjedhojë, ata vazhdojnë të mbeten të regjistruar si pronarë, gjë që ndikon në të drejtën e tyre për të përfituar nga programet e mbështetjes sociale” dhe në detyrimin për të paguar taksat, ndërkohë që në realitet ata nuk janë më pronarë të ligjshëm.

Romët dhe egjiptianët përballen gjithashtu me barriera të fshehta në punësim, duke përfshirë distancën nga puna/shkolla, diskriminimin dhe stigmatizimin e të qenit rom/egjiptian, shpeshhtësinë e migrimit, mungesën e kartave të identitetit dhe të dokumenteve të tjera personale dhe administrative, mungesën e informacionit mbi ekzistencën e programeve të punësimit, etj³⁰. Duke mos pasur informacionin e mjaftueshëm rreth avantazheve të regjistrimit si të papunë, shumë romë nuk kanë akses në masat e marra për arsimin dhe formimin profesional dhe në masat e tregut aktiv të punës. Pjesa më e madhe e zyrave të punës dhe e shkollave apo qendrave profesionale, nuk kanë asnjë të punësuar me origjinë rome ose egjiptiane, gjë që sjell keqkuptime mes administratës dhe komuniteteve dhe ndonjëherë edhe qëndrime diskriminuese gjatë ofrimit të shërbimit.

Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për numrin e të rinjve Rom që ndjekin shkollat e arsimit profesional , mendohet se numri i tyre është pothuajse i pakonsiderueshëm. Mendohet se rritja

29 Ministria e Ekonomisë ka një program të limituar për promovimin e sipërmarrjes, por që nuk trajton grupet vulnerabël.

30 PNUD, Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës, Beratit dhe Vlorës, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 21.



në frekuentimin e shkollave profesionale nga të rinjtë Rom/Egjiptianë do të jetë një alternativë shumë e mirë edhe për rritjen e përfshirjes së tyre në tregun e punës. Gjithashtu rritja e aftësive të tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional që aktualisht ofrohen falas do të ishte një oportunitet për punësim dhe rritjen e nivelit të jetesës. Kjo do të kërkonte promovimin nga strukturat shtetërore të arsimit dhe formimit profesional por edhe zbatimin e masave specifike për përfshirjen e këtyre komuniteteve në sistemin e arsimit profesional.

Kujdesi shëndetësor

Të dhënat e disponueshme aktualisht nuk tregojnë nëse ka dallime të konsiderueshme në gjendjen shëndetësore mes grupeve etnike në Shqipëri. Gjithsesi, kërkimi i kryer nga BE-ja tregon se “mesatarisht romët kanë një moshë vdekjeje të paktën dhjetë vjet më të re sesa popullsia jo-rome, kanë akses më të ulët në shërbimet shëndetësore dhe kanë shkallë më të lartë të vdekshmërisë foshnjore”³¹.

Studimi rajonal i PNUD/KE/BB i vitit 2011, tregoi mungesë të lartë të sigurimit shëndetësor midis romëve të intervistuar në Shqipëri (68% nuk ishin fare të siguar, krahasuar me 46% të popullsisë jorome që jeton pranë tyre), në dallim të theksuar me pjesën më të madhe të vendeve të tjera të marra në shqyrtimi nga ky studim³². Të gërshetuara me varfërinë që i pengon romët dhe egjiptianët të paguajnë për shërbimet dhe mjekimet, këto vështirësi ndikojnë në jetëgjatësinë më të shkurtër të tyre dhe në sëmundjet kronike.

Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile raportojnë për “trajtim jo të mirë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, pengesa komunikimi dhe shkelle të së drejtës për kujdes shëndetësor”³³. Si pasojë, shumë romë dhe egjiptianë nuk drejtohen fare në qendrat lokale shëndetësore, por shkojnë direkt në spital, zakonisht në fazat e avancuara të sëmundjes, duke e ditur se atje do të përfitojnë trajtim urgjent falas. Anketa e vitit 2013 e OSFA nxorri në pah që 56% e të përgjigjurve kërkuan mbështetje nga një qendër shëndetësore apo spital 4 deri në 10 herë përgjatë viti 2012, fakt që tregon për një nevojë të lartë për këto shërbime³⁴. Fëmijët, që përfaqësojnë 38 për qind të popullsisë rome³⁵, janë në një pozicion veçanërisht të cënueshëm dhe kalojnë sëmundje kronike në 5.6 për qind të rasteve³⁶ (përfshirë sëmundje respiratore, infektive dhe goditje epileptike) dhe

31 Komisioni Evropian, Raport mbi shëndetin e komunitetit rom: Gjendja shëndetësore e popullsisë rome dhe monitorimi i të dhënave të mbledhura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, prill 2014, http://ec.europa.eu/health/social_determinants/docs/2014_roma_health_report_en.pdf, f. 37.

32 PNUD/Banka Botërore/KE, Gjendja shëndetësore e komuniteteve rome, pjesë e studimit rajonal për romët të vitit 2011, publikuar në vitin 2013, f. 36.

33 Monitoruesi i Dekadës së Përfshirjes së Romëve, Raporti i monitorimit të shoqërisë civile për implementimin e strategjisë kombëtare të integritetit të komunitetit rom dhe të planit të veprimit të dekadës në vitin 2012 në Shqipëri, maj 2013, f. 10.

34 OSFA, The Decade of Roma and the Situation of Roma in Albania, 2012, publikuar në 2013.

35 Sipas censusit të OSFA, 38 për qind e romëve janë nën moshën 18 vjeç.

36 UNICEF dhe Qendra e Studimeve Sociale dhe Ekonomike, Identifikimi i fëmijëve romë në Shqipëri, 2011,



nuk marrin kujdes shëndetësor në baza të rregullta.

Shumë romë dhe egjiptianë nuk mund të shkojnë te mjeku i familjes, për shkak të pamundësisë për të transferuar zyrtarisht vendbanimin e tyre ose mungesës së dokumenteve personale ose librezës shëndetësore. Shumë familje rome jetojnë në zonat e grumbullimit të mbetjeve ose në rrugë, kështu që nuk mund të pajisen me dokumentet e nevojshme dhe në të njëjtën kohë kanë risk të madh shëndetësor për shkak të kushteve të jetesës. Ata nuk mund të paguajnë shërbimet shëndetësore dhe mjekimin, dhe ndonjëherë duke mos qenë të regjistruar në sistemin e mbrojtjes sociale, nuk mund të përfitojnë nga skemat e rimbursimit apo të uljes së çmimit.

Kushtëzimi i aksesit ndaj kujdesit shëndetësor nga regjistrimi në zyrat e punësimit ka krijuar një barrierë për romët dhe egjiptianët të cilët shpesh mbijetojnë me aktivitete informale dhe preferojnë të mos regjistrohen si të papunë. Një rast studimi i realizuar në vitin 2013 në një komunë të Shushicës (Vlorë), arriti në përfundimin se 79 për qind e romëve të pyetur dhe 63 për qind e egjiptianëve nuk kishin kartë shëndeti dhe kjo u evidentua si pengesa kryesore në marrjen e shërbimeve shëndetësore. Numri e lartë i romëve pa karta shëndeti (50 për qind) është identifikuar gjithashtu nga anketimi i vitit 2012 zhvilluar nga OSFA³⁷.

Qeveria ka në plan të prezantojë aksesin universal ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor falas³⁸, të cilat do të financohen nga taksat e përgjithshme. Kjo do të bëjë të mundur që personat të cilët nuk disponojnë dokumentacionin e duhur (përfshirë, për shembull, fëmijët që jetojnë në rrugë) të mund të kenë akses në sistemin e kujdesit shëndetësor. Sistemi i ri është planifikuar të nisë zbatimin në vitin 2017 dhe do të kërkojë ndryshime ligjore. Romët dhe egjiptianët do të kenë nevojë për mbështetje gjatë periudhës tranzitore si dhe për të pasur akses në sistemin e ri.

Aktualisht, vetëm ata romë dhe egjiptianë që janë të regjistruar si të papunë, me aftësi të kufizuara, shtatzënë apo të mitur mund të përfitojnë kujdes shëndetësor falas. Ata të cilët punojnë në mënyrë informale për të mbijetuar, nuk janë pjesë e regjistrimit të të papunëve duke humbur kështu të drejtën për akses ndaj sigurimit shëndetësor. Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve parashikon aktivitete më intensive për shtrirjen e shërbimeve dhe ndihmës për romët dhe egjiptianët që përfshihen në kategorinë e atyre që përfitojnë kujdes shëndetësor falas (me aftësi të kufizuara, shtatzënë, nën moshën 18 vjeç, të regjistruar si të papunë) por që ende nuk zotërojnë kartën e shëndetit.

Plani i Veprimit parashikon gjithashtu krijimin e njësive të lëvizshme të personelit shëndetësor dhe prezantimin e ndërmjetësuesve shëndetësorë (që vijnë nga komunitetet rome dhe egjiptiane), për të lehtësuar dhe siguruar shtrirjen e shërbimeve shëndetësore në komunitetet

http://www.sidalbania.org/Mapping_roma_children_english_may_5_2012.doc, f. 7.

37 OSFA, The Decade of Roma and the Situation of Roma in Albania, 2012, published in 2013.

38 Qeveria e Shqipërisë, Konkluzionet Operacionale nga Seminari i Dialogut Politik për Përfshirjen e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, 20-21 shkurt 2014, f. 7.



më të cënueshme³⁹. Aktualisht, infermierët vizitojnë fëmijët e sapolindur dhe mjekët vizitojnë pacientët që nuk mund të lëvizin, por shërbimet shëndetësore mobile ndaj romëve, egjiptianëve dhe banorëve të tjerë në zonat e izoluara duhet të zgjerohen dhe të bëhen të qëndrueshme, sidomos për fëmijët romë dhe egjiptianë gjatë viteve të para të jetës për të garantuar impakt dhe zhvillim të mirë të shëndetit të fëmijës në vitet e ardhshme.

Strehimi dhe integrimi urban

Romët dhe egjiptianët jetojnë në kushte të këqija banimi ku shpesh mungojnë instalimet hidrosanitare, jetojnë në zona periferike dhe pa infrastrukturë pranë. 16 për qind e familjeve rome nuk furnizohen me ujë të rrjedhshëm në shtëpitë e tyre dhe as jashtë saj, ndërkohë që 28% e familjeve rome jetojnë në banesa që nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimit të ujërave të zeza⁴⁰. Nga një studim më i hershëm janë siguruar të dhëna të disagreguara për familjet rome dhe egjiptiane, sipas të cilave 38,8% e banesave të banuara nga romët nuk furnizohen me ujë të pijshëm, krahasuar me 20,8% të familjeve egjiptiane⁴¹. Përqindje të ngjashme përshkruajnë aksesin në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimit të ujërave të zeza.

Gjithashtu familjet rome dhe egjiptiane shpesh banojnë në banesa nën standard dhe vuajnë pasigurinë e qiramarrjes. Sipas studimit të OSFA-së, 67% e familjeve rome jetojnë në shtëpi private përdhese, pesë për qind në banesa të përshtatura si ish-magazina, kabanone etj, 15% në baraka dhe vetëm 13% në blloqe apartamentesh. Në 38% të rasteve, të gjithë anëtarët e familjes jetojnë në një dhomë të vetme. Studimi i PNUD konstatoi se shumica e romëve jetojnë në ndërtesa të dëmtuara (38,4%) ose në baraka (20,8%), krahasuar me 45,8% dhe 10,9% të egjiptianëve⁴². 68 % e familjeve rome (2.967 familje në total) nuk posedojnë dokumente që vërtetojnë pronësinë mbi shtëpinë. Si pasojë ata jetojnë me riskun për t'u nxjerrë nga shtëpitë dhe/ose për t'u kthyer në të pastrehë⁴³. Nuk ka të dhëna rreth pronësisë së familjeve egjiptiane mbi pronën.

Në pamje të parë kjo situatë duket e lidhur drejtpërdrejt me varfërinë, por në fakt është më komplekse se kaq. Megjithëse qeveria shqiptare ofron një numër të konsiderueshëm programesh strehimi (shih Tabelën 2), ato mbeten mjaft të vështira për t'u aksesuar nga romët dhe egjiptianët.

39 Po aty, f. 8.

40 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014.

41 Të dhëna nga studimi social-ekonomik PNUD/BB/KE 2011, të cituara në studimin e PNUD-it për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, shkurt 2012, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/roma-needs-assessment-report/>, f. 24-25.

42 Po aty.

43 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014.

Ndër arsyet kryesore janë mungesa (e verifikueshme) e të ardhurave që do t'i mundësonte atyre pjesëmarrjen në disa programe, varfëria e cila i pengon njerëzit të paguajnë tarifat e legalizimit⁴⁴, diskriminimi dhe mungesa e dokumentacionit dhe njohurive rreth kësaj fushe me karakter mjaft teknik.

Tabela 2: Përmbledhje e programeve të strehimit

44 Ndërsa vetë procesi është pa pagesë por aplikantët duhet të paguajnë vlerën e tokës, taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe noterizimin e dokumenteve.



Programi	Përshkrimi	Grupi i synuar i mundshëm	Të ardhurat minimale	Agjencia zbatuese
Banesat me kosto të ulët	Ndërtim i ri	Punëtorë, me të ardhura të ulëta deri në mesatare	39,587 Lekë/ m2 bazuar në Udhëzimin e KM për vitin 2015	Enti Kombëtar i Banesave ose Bashkitë
Subveçionimi i interesit të kredisë së lehtësuar	Kredia është dhënë nga banka private për blerjen e shtëpive në treg; interesi subveçionohet pjesërisht nga buxheti i shtetit	Të gjitha grupet e përcaktuara në ligj që plotësojnë kushtet e përcaktuara. Të ardhurat mesatare.	Në varësi të çmimeve të tregut në qytete të ndryshme. Në Tiranë 89,125 Lekë bazuar në Udhëzimin e KM për vitin 2015.	Partneritet Publik-Privat
Strehimi social	Ndërtim i ri	Të ardhura mesatare e të ulëta	39,587 Lekë/m2 bazuar në Udhëzimin e KM për vitin 2015	Bashkitë
Bonusi i strehimit (vlëra)	Grant nga qeveria lokale për pagesën e qirasë së tregut. Grande nga qeveria qendrore për disa kategori të përcaktuara në ligjin 9232.	Të ardhura të ulëta-nën mesatare	Në varësi të çmimeve të qirave të tregut në qytete të ndryshme. Për Tiranën -42.000 Lekë	Vetë-rregullim, Bashkitë
Subveçion i qirasë për banesat sociale me qira në pronësi të bashkive	Grant nga qeveria qendrore për pagesën e qirasë për personat me të ardhura të ulëta	Të ardhura shumë të ulëta	Kur qiraja sociale kalon 25% të të ardhurave neto të familjes	Bashkitë
Zhvillimi i tokës për qëllime strehimi ¹	Zona e ndërtimit dhe shërbimet	Të ardhura të ulëta-në shumë të ulëta		Bashkitë
Grante të vogla	Përmirësimi i kushteve të banimit	Romët Komuniteti	650.000 lekë/ njësi banimi për rikonstrukcion Për ndërtime të reja kosto mesatare 39,587 Lekë/ m2 dhe nuk do të kalojë vlerën 1.200.000 lekë/familje	Bashkitë

* Të ardhurat minimale janë llogaritur në bazë të përcaktimeve ligjore dhe treguesve të tjerë si kosto e ndërtimit nga EKB, çmimet mesatare të tregut dhe kushtet e kredisë hipotekare. Këto të dhëna shërbejnë vetëm si tregues dhe nuk do të konsiderohen si përfundimtare.

Burimi: PNUD, Politikat dhe praktikat e strehimit për romët në Shqipëri, shtator 2013, f. 24 (rishikuar me MZHU)

Ka ende pengesa për aplikimet e romëve dhe egjiptianëve në programet e strehimit pasi ata nuk arrijnë të plotësojnë kriteret lidhur me të ardhurat minimale nga burime të verifikueshme.

Gjithashtu, shumë romë nuk janë në gjendje ta transferojnë vendbanimin e tyre në bashkinë ku ata jetojnë dhe për këtë arsye nuk kualifikohen për programet lokale të strehimit. Romët dhe egjiptianët ndryshojnë si komunitete në këtë aspekt: studimet raportojnë se egjiptianët janë më pak të varur nga puna informale dhe si rrjedhojë, mendohet të jenë më të aftë në zgjidhjen e nevojës për strehim⁴⁵. Avokati i Popullit mori në shqyrtim çështjen e përjashtimit të romëve nga strehimi social dhe rekomandoi heqjen e kriterit të të ardhurave minimale për romët dhe futjen e kuotave në nivel lokal, për të siguruar përfaqësimin e romëve midis përfituesve të strehimit social⁴⁶. Megjithatë, deri tani nuk ka pasur ndonjë progres dhe Plani i Veprimit përfshin aktivitete plotësuese për trajtimin e situatës.

Në rekomandimet e dhëna nga ana e Avokatit të Popullit, për nevojën e ndryshimeve të ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, drejtuar Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, është sugjeruar që të parashikohem dispozita tranzitore të kufizuara në kohë, të cilat do të konsiderohen si masa të vecanta të përkohshme që lehtësojnë aksesin në programet e strehimit social, deri në momentin e përthithjes reale të ketij komuniteti në sistem apo dhe të integritetit të tij social.

Banesat e romëve dhe egjiptianëve shpesh ndërtohen në mënyrë të paligjshme dhe procesi i legalizimit është i pavolitshëm për t’u zhvilluar. Një studim i Entit Kombëtar të Banesave në vitin 2006, tregoi se vetëm 4,3% e familjeve romë kishin pronësi mbi tokën ose shtëpinë e tyre, 87% kishin uzurpuar tokë private (objekt i kthimit të pronave) dhe pjesa tjetër e banesave gjendeshin mbi tokë publike. Për rrjedhojë, romët dhe egjiptianët jetojnë në rrezikun e vazhdueshëm të nxjerrjes me forcë nga banesat e tyre dhe nuk mund të përfitojnë nga kompensimi në rast se nxirren për shkak të punimeve publike. Të ngecur në këtë rreth vicioz, ata nuk mund të legalizojnë banesat e tyre ose të përfitojnë nga strehimi social, bashkia nuk siguron infrastrukturën për banesat e jashtëligjshme dhe kjo gjë kontribuon në përjetësimin e varfërisë.

Gjithashtu, romët dhe egjiptianët shpesh nuk janë në gjendje të aplikojnë për legalizim të banesave të tyre ekzistuese. Arsyet për këtë përfshijnë tipin e ndërtimit (jo në gjendje të mirë strukturore dhe të papërshtatshme për legalizim), mos ekzistencën e planeve urbane, mungesën e mjeteve financiare për ndjekjen e procedurave dhe kryerjen e pagesës për tokën, mungesa e aftësisë për të kuptuar procedurat e legalizimit, etj. Studimi i kryer nga OSFA evidentoi vetëm 654 familje të cilët kanë aplikuar për legalizim⁴⁷ dhe deri sot, siç raportohet asnjë rom nuk ka arritur të legalizojnë banesën e tij në Tiranë.

Nuk ekzistojnë të dhëna për pjesëmarrjen e egjiptianëve në procesin e legalizimit.

45 Po aty, f. 29.

46 Zyra e Avokatit të Popullit, Rekomandim legjislativ për një ndryshim në ligjin nr. 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), 2013, f. 6.

47 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën romë në Shqipëri, prill 2014, f. 30.



Pas krijimit të qeverisë së re në shtator 2013, rasti i familjeve rome të dëbuara u trajtua me prioritet. Ministria Mirëqenies Sociale dhe Rinisë u angazhua për gjetjen e zgjidhjes dhe paraqiti pesë vende të mundshme për strehim në qytetin e Tiranës për t'u marrë në konsideratë nga romët. Ministria përmirësoi kushtet infrastrukturore të një ish zone ushtarake në Tufinë (pasi ky ishte opsioni i zgjedhur nga romët) dhe ndërtoi një Qendër Tranzitore për strehimin e përkohshëm të familjeve të dëbuara. Gjithashtu për strehimin emergjent të familjeve rome të cilat nuk përfitojnë nga shpronësimet qeveria shqiptare miratoi VKM nr. 230, datë 13.5.2015, nëpërmjet të cilës familjet rome që u prishën banesat nga ndërtimi i rrugës "Unaza e madhe e Tiranës", përfitojnë qira të banesës për dy vjet.

Qeveria shqiptare alokoi 30.000.000 Lekë (rreth 215.000 Euro) në buxhetin e saj për vitin 2014 për strehimin dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve. Këto fonde u përdorën për rikonstruksionin e banesave të komunitetit Rom në bashkinë e Lushnjës.

Në total gjatë vitit 2015, rreth 290 familje të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të përfitojnë direkt dhe indirekt nga implementimi i këtij programi në projektet e zbatuara në Bashkitë Rrogozhinë, Elbasan, Përmet, Vlorë, Berat, Lezhë, Lushnje, Sarandë dhe Rrëshen. Gjithashtu ata do të përshihen në punësim në fazën e zbatimit të tij duke ndikuar sado pak në cilësinë e jetës së tyre.

Gjatë dy viteve të para të Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, financimi për përmirësimin e kushteve të strehimit të romëve nëpërmjet granteve të vogla do të rritet në mënyrë të konsiderueshme por do të fillojë të bjerë në vitin 2017. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të shtohen financimet nga buxheti i shtetit, të garantohet shpenzimi sa më eficient i financimeve në dispozicion dhe të sigurohet se bashkitë dhe përfituesit dinë se si t'i aksesojnë këto burime.

Mbrojtja sociale

Niveli i varfërisë në radhët e komunitetit Rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, shkalla e papunësisë së tyre është tre herë më e lartë se mesatarja⁴⁸. Të ardhurat për rreth 48% të familjeve rome janë më pak se 10.000 lekë/muaj (afërsisht 70 euro), ndërsa 35% e familjeve kanë raportuar të ardhura mujore prej më pak se 20.000 lekë⁴⁹. Programet e mbrojtjes sociale luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e gjendjes së familjeve rome dhe egjiptiane, duke ofruar shërbimet e ndihmës financiare (ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar), të mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimet me bazë komunitetin.

Në zbatim të Ligjit Nr. 9355/2005 për "Ndhimën dhe Shërbimet Shoqërore", programi i Ndhimës Ekonomike ndihmon mesatarisht 80.000 familje me një pagesë mujore kesh/ me para në

48 Sekretariati Qendror i Dekadës së Përfshirjes Rome, Raporti i monitorimit të shoqërisë civile për implementimin e strategjisë kombëtare të integritit të komunitetit rom dhe të planit të veprimit të dekadës në vitin 2012 në Shqipëri, maj 2013, f. 20.

49 OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014.



dorë⁵⁰. Përfitime të tjera përfshijnë subvencionimin e energjisë elektrike dhe ofrimi i ndihmës për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Gjithsesi, romët dhe egjiptianët kanë më pak gjasa të plotësojnë kriteret për përfitimin nga shërbimet sociale (duke përfshirë ndihmën ekonomike) për shkak të mungesës së dokumenteve personale ose të transferimit formal të vendbanimit, analfabetizmit ose paaftësisë për të plotësuar formularët e aplikimit, procedurave të komplikuara, ekzistencës së një pronësie ligjore mbi toka që ata nuk i zotërojnë de-fakto etj. Ndonjëherë, ata humbasin përfitimet për shkak të pamundësisë për të rregjistruar transferimin e vendbanimit brenda afatit të caktuar. Familjet rome dhe ato egjiptiane që nuk janë të rregjistruara për të përfituar nga ndihma ekonomike ose që nuk kanë dokumentet e nevojshme për të hyrë në këtë sistem nuk mund të përfitojnë as nga një gamë shërbimesh të tjera, duke përfshirë, kujdesin shëndetësor, strehimin social apo ndihmën juridike falas.

Gjatë këtyre viteve, synimi i qeverisë ka qenë përmirësimi i rishpërndarjes së burimeve të saj dhe ulja e varësisë ndaj ndihmës financiare përmes kërkesës për punë. Ndërkohë që mbulimi i të varfërve ekstremë është përmirësuar, niveli i ndihmës mbetet i ulët dhe vetëm 2.000 familjet rome dhe egjiptiane janë përfshirë në skemën e NE nga 80.000 familje gjithsej, për shkaqet e përmendura më sipër⁵¹. Nëpërmjet një VKM-je, niveli i pagesës është përcaktuar në proporcion me numrin e fëmijëve dhe një shumë speciale ekstra i shtohet përfituesve, fëmijët e të cilëve janë vaksinuar dhe ndjekin rregullisht shkollën. Këto pagesa i jepen si burrave ashtu dhe grave me qëllim që të kenë akses të njëjtë ndaj fondeve. Pilotimi i skemës së ndihmës ekonomike në tre rajone (Tiranë, Durrës, Elbasan), përveç avantazheve, ka sjellë edhe disa sfida dhe vështirësi të pretenduara nga familje dhe organizata, sidomos në Elbasan, gjë që kërkon ndërhyrje në përmirësimin e procedurave të ankimimit.

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale evidenton problemet e mëposhtme në sistemin e ndihmës ekonomike:

50 Po aty, f. 21.

51 Bazuar në të dhënat e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.



- Identifikimi i familjeve të varfra është i vështirë si pasojë e pasaktësive në regjistrat e gjendjes civile, ku shpesh nuk reflektohet migrimi i popullsisë; volumi i madh i dokumentacionit të kërkuar i cili rrit rrezikun për gabime në plotësim dhe presionin për pagesa dhe transaksione të paligjshme; dhe mospërputhja e treguesve administrativë dhe treguesve të varfërisë.
- Bllok grantet e marra nga njësitë e qeverisjes vendore nuk reflektojnë nivelin e varfërisë së atij komuniteti si rezultat i mungesës së informacionit të nevojshëm nga ana e pushtetit vendor.
- Mbulimi dhe nivelet e pagesave janë të ulëta, çka bën që efekti në uljen e varfërisë të jetë shumë i vogël (pagesa mesatare është e barabartë me më pak se 15% e kufirit të varfërisë)⁵².

Në vitin 2012, Avokati i Popullit nxori në pah disa pengesa me të cilat përballen romët në aksesin në shërbimet sociale, konkretisht duke iu referuar familjeve rome që më parë kanë jetuar në fshatra dhe janë regjistruar në qytete pas datës 1 gusht 1991. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe përmasave të ndihmës sociale”, këto familje duhet të vërtetonin që nuk kishin në pronësi toka në fshatin nga i cili vinin dhe që ishin shpërngulur për arsye punësimi⁵³. Gjithashtu, nëse këta persona kishin përfituar nga ndihma ekonomike në vendin e tyre të mëparshëm të banimit, u caktohej një afat prej 30 ditësh për t’u regjistruar në qytetin e ri të banimit, në mënyrë që të vazhdonin të merrnin ndihmën⁵⁴. Avokati i popullit shpjegoi se familjet rome shpesh nuk mund të plotësonin këto kërkesa⁵⁵, gjithsesi ende nuk është gjetur një zgjidhje për të gjithë sistemin.

Përparimet në integrimin e shërbimeve sociale dhe të punësimit janë testuar veçanërisht nga pengesat që romët dhe egjiptianët hasin në kalimin nga ndihma ekonomike në punësim. Sikurse përshkruhet në seksionin për punësimin dhe AFP-në, hyrja e romëve dhe egjiptianëve në këto programe mbetet e ulët, duke e bërë kështu ndihmën ekonomike burimin e vetëm të besueshëm të të ardhurave të tyre.

Shërbimi i fuqizimit të familjes dhe shërbime të tjera me bazë komunitetin të nevojshme për parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve të rrugës dhe viktimave të trafikimit njerëzor janë të kufizuara. Gjithashtu ka një monitorim të kufizuar të ofrimit të shërbimeve të komunitetit dhe të koordinimit/referimit në programe të tjera mbështetëse (p.sh. punësim, strehim, AFP dhe arsim).

Qeveria licencon ofruesit e shërbimeve shoqërore që punojnë për mbrojtjen e fëmijëve, mbështesin viktimat e dhunës dhe trafikimit, ofrojnë ndihmë psiko-sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe shërbime të tjera në nivel lokal. Këto shërbime kanë shumë rëndësi për romët

52 Po aty, f. 10.

53 Vendimi nr. 787/2005 (i rishikuar), pika 3 e Kreut I.

54 Po aty, pika 5 e Kreut I.

55 Zyra e Avokatit të Popullit, Rekomandimet ligjore për ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 787/2005 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe përmasave të ndihmës sociale” (i rishikuar), 2012.



dhe egjiptianët, veçanërisht për trajtimin e nevojave të fëmijëve të rrugës, viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës mbi bazë gjinore në familje, njerëzve që jetojnë në vendbanime të izoluara dhe informale dhe grupeve të tjera të cenueshme.

Grupet e fëmijëve më në risk përfshijnë fëmijët që migrojnë, që jetojnë në rrugë dhe fëmijët që detyrohen me forcë të punojnë ose vuajnë të tjera forma shfrytëzimi. Një iniciativë pilote për mbrojtjen e këtyre grupeve të fëmijëve po zbatohet në Tiranë nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, Drejtoria Rajonale Arsimore dhe organizatat e shoqërisë civile. Një studim mbi profilizimin e fëmijëve në situatë rruge ka treguar se 70 për qind e tyre janë nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Po ndiqet qasja e menaxhimit të rastit, e cila në të ardhmen do të kombinohet me një shtrirje më të madhe të shërbimeve komunitare. Rreth 100 fëmijë vendosen në institucione të kujdesit social çdo vit dhe afërsisht 30-40 për qind e tyre vijnë nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Kjo është një masë emergjente e qeverisë për t'u përgjigjur situatës emergjente të numrit të madh të fëmijëve në situatë rruge. Gjithë mënyrat e tjera të trajtimit afatgjatë të këtyre fëmijëve janë duke u eksploruar nëpërmjet procesit të deinstitutionalizimit, i cili është në proces.

Përgjigjja ndaj nevojave të familjeve që jetojnë në rrugë (veçanërisht fëmijët) kërkon masa të koordinuara mes institucioneve arsimore, shërbimeve sociale dhe policisë. Qendra Tranzitore e Emergjencave në Tiranë trajton së bashku familjet dhe fëmijët. Kjo Qendër gjithashtu punëson familjet që jetojnë atje, siguron pako me të mira materiale, lehtëson rregjistrimin në gjendjen civile dhe siguron rregjistrimin e fëmijëve në shkolla. Disa romë gjithashtu punojnë për institucione të tjera rezidenciale. Gjithsesi ky plan thekson se roli i Qendrës Tranzitore të Emergjencave në Tiranë duhet të përcaktohet më qartë në mënyrë që kjo ndërhyrje pilot të mund të vazhdojë të mbështesë në të ardhmen familjet më vulnerabël (duke përfshirë përcaktimin e kapaciteteve të qëndrës si dhe procedurat për rregjistrimin e përfituesve të rinj). Qendra duhet të vazhdojë të vlerësojë nevojat e çdo fëmije dhe familjeje rast pas rasti në mënyrë që të përcaktohet gama e shërbimeve që nevojiten për t'i çuar ata drejt pavarësisë, punës së denjë dhe përfshirjes në komunitetin vendas. Fuqizimi i familjeve duhet të vazhdojë të jetë prioritet i Qendrës, me qëllim lehtësimin e riintegritimit në shoqëri.

Reforma në sistemin e pensioneve ndikoi pozitivisht në jetesën e romëve dhe egjiptianëve të moshuar. Ligji i ri, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2015, parashikon përfitimin e pensionit social për personat mbi 70 vjeç, të cilët nuk kanë mundur të paguajnë kontributet për arsye specifike. Ky pension synon të sigurojë nevojat bazë për personat që nuk kanë burime të tjera të ardhurash.





V

Vizioni dhe Qëllimet Strategjike



V – VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Vizioni : Rritja e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të barrierave për Romët dhe Egjiptianët gjatë pesë viteve të ardhëshme, do të sjellë një shëndet më të mirë , një arsimim më të plotë , rritjes së mirëqenies nëpërmjet punësimit formal e si pasojë integritit të plotë të këtyre komuniteteve.

Qëllimet Strategjike:

Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të rregjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët.

- ▶ *Synimi: Në fund të vitit 2020, 100% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile. Baseline : 67%*

Romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.

- ▶ *Synimi: Në fund të vitit 2020, 70% më shumë djem dhe vajza të komunitetit Rom dhe Egjiptian arrijnë të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit dhe 100% përfundojnë arsimin parashkollor.*

Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.

- ▶ *Synimi: 80% me shume gra dhe burra romë dhe egjiptianë të cilët marrin pjesë në AFP dhe programet aktive të punësimit do të integrohen në tregun e punës deri në fund te vitit 2020.*

Garantimi i një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përballueshëm dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët.

- ▶ *Synimi: 100% e anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian do të kenë mundësi të përdorin shërbimet bazë shëndetësore deri në fund të vitit 2020.*

Përmirësimi i kushteve të strehimit për romët dhe egjiptianët.

- ▶ *Synimi: 80% e familjeve Rome dhe Egjiptiane, të cilët kanë inicuar procedurat e legalizimit, i kanë përfunduar ato suksesshëm deri në fund të vitit 2020.*

Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian.



- ▶ *Synimi: 65% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të jenë të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të vitit 2020.*







VI

Objektivat e Politikës



VI – OBJEKTIVAT E POLITIKËS

Plani i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020 vjen si një dokument politik i qeverisë shqiptare që adreson problematikat dhe çështjet kryesore që ndikojnë në jetën e komuniteteve rome dhe egjiptiane duke krijuar shpeshherë diferenca në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.

Ky Plan Veprimi ngrihet gjithashtu mbi dokumentet e mëparshme të politikave specifike që nxisin përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri. Në vitin 2003, qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom 2003-2013, të ndjekur nga Plani Kombëtar i Veprimit për Romët 2010-2015 që u miratua pas aderimit të vendit në Dekadën e Përfshirjes Rome. Këto dokumente janë përdorur për të udhëhequr programet publike që synojnë të përmirësojnë statusin e romëve dhe egjiptianëve.

Në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë në BE , qeveria shqiptare ka miratuar tashmë disa dokumenta, sic janë Plani Kombëtar i Integrimit European 2016-2020, Udhërrëfyeni për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me Komisionin European organizuan një seminar në muajin Shkurt 2014, i cili solli së bashku të gjithë aktorët e interesuar për të analizuar situatën e komunitetit Rom/Egjiptian në Shqipëri por edhe për të dhënë rekomandime për masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e jetesës së tyre dhe sidomos për integrimin e qëndrueshëm të komuniteteve rome dhe egjiptiane përmes përgatitjes së një Plani Veprimi. Rekomandimet e këtij seminari u përdorën si bazë për të udhëhequr hartimin e Planit të Veprimit dhe janë pasqyruar në aktivitetet e tij.

Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, “masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”⁵⁶. Përbushja e Prioritetit 5 në Udhërrëfyenin e Qeverisë, orienton marrjen e masave në shumë fusha të politikave specifike për Romët/Egjiptianët si: rregjistrimi civil , aksesimi në drejtësi, arsimit, dialogu ndërkulturor, punësimi dhe përmirësimi i aftësive, kujdesi shëndetsor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale. Janë pikërisht këto fusha që kanë orientuar objektivat kryesore të përcaktuara në këtë dokument.

Gjithashtu duke marrë parasysh angazhimet e përkrahura në dokumentin Udhërrëfyeni Plani i Veprimit jep një listë më të detajuar të aktiviteteve që do të zbatohen gjatë periudhës 2016-2020.

56 Bashkimi Evropian, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.



Objektivat e politikave janë grupuar sipas fushave të poshtëshënuara.

Fusha e politikës: Akses i barabartë në rrigjistrimin civil dhe në drejtësi.

Objektivi 1: Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të komunitetit Rom dhe Egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile.

Objektivi 2: Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi si dhe referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e rasteve të trafikuar.

Fusha e politikës: Arsimimi dhe promovimi i dilaogut ndërkulturor.

Objektivi 1: Më shumë djem dhe vajza rome dhe egjiptiane që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit.

Objektivi 2: Promovimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët përmes zhvillimit të komuniteteve mbi bazë shkolle.

Objektivi 3: Të forcohet bashkëveprimi i shkollës me shërbimet sociale, për adresimin e rasteve të fëmijëve romë dhe egjiptianë me probleme sociale-ekonomike.

Objektivi 4: Promovimi i njohjes së identitetit Rom dhe atij Egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.

Fusha e politikës: Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)

Objektivi 1: Integrimi i romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës nëpërmjet AFP-së dhe programeve aktive të punësimit.

Objektivi 2: Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe vetëpunësimit i romëve dhe egjiptianëve.

Objektivi 3: Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së punës së punonjësve të zyrave të punësimit dhe të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës.

Fusha e politikës: Kujdesi Shëndetësor



Objektivi 1: Rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve që përdorin shërbimet bazë shëndetësore.

Objektivi 2: Përmirësimi i informimit dhe promovimit shëndetësor për shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët.

Fusha e politikës: Strehimi dhe Integrimi urban

Objektivi 1: Përmirësimi i mekanizmave që do të ndikojnë në lehtësimin e familjeve të komunitetit Rom dhe Egjiptian për procedurat e legalizimit.

Objektivi 2: Më shumë familje rome dhe egjiptiane të përfshira në programet e strehimit direkt dhe indirekt.

Fusha e politikës: Mbrojtja Sociale

Objektivi 1: Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale.

Objektivi 2: Nxitja/ndërtimi i programeve për riintegrimin me fokus forcimin e familjes dhe riintegrimin në punë.

Objektivi 3: Riintegrimi në shoqëri i familjeve që qëndrojnë në Qendrën Tranzitore të Emergjencave.





VII

Kuadri Vlerësues dhe Monitorues



VII – KUADRI VLERËSUES DHE MONITORUES

Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian 2016-2020, është një dokument politikash specifike për komunitetet e targetuara por ne përputhje të plotë me të gjitha startegjitë sektoriale e nën obrellën e Startegjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI). Në këtë kontekst procesi i monitorimit të zbatimit të tij do të jetë një proces ndersektorial.

Kuadri vlerësues dhe monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuader të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e resurseve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me Urdhërin e Kryeministrit Nr.129 datë 21.09.2015 “Për marrjen e masave institucionale dhe operacionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP). GMIP-të do të monitorojnë reformat sektoriale në Shqipëri në përputhje me Prioritetet e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), procesin e anëtarësimit në BE dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij Plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve në takimet e Nën Grupit Tematik të Përfshirjes Sociale që do të udhëhiqet nga MMSR dhe përberje të strukturave ndërsektoriale.

Në nivel më bazik për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, përgjegjëse do të jenë pikat e kontaktit për romët dhe egjiptianët në ministritë e linjës, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet e informacionit që nevojitet. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit. Plani i Veprimit parashikon publikimin e progres raporteve vjetore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile. Sfidat për një funksionim më të plotë të kuadrit monitorues mbetet ndërveprimi me strukturat e nivelit vendor.

Ministritë përgjegjëse do të punojnë me përfaqësuesit rajonal dhe të bashkive të vendit për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Të dhënat administrative përdoren nga pjesa më e madhe e ministrive për të monitoruar pjesëmarrjen e romëve dhe të një pjesë më të vogël egjiptianësh në programet e përgjithshme dhe të synuara të qeverisë, siç janë promovimi i punësimit, AFP, ndihma ekonomike etj. Gjithsesi, procesi i vetëdeklarimit si romë ose egjiptianë nuk është i standardizuar dhe disa struktura në nivel vendor hezitojnë të mbledhin këto të dhëna nga frika se mos dhunojnë të drejtat e privatësisë. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të



gjitha zyrat shtetërore përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të romëve dhe egjiptianëve. Mungojnë veçanërisht të dhënat mbi gjendjen e egjiptianëve.

Në nivel politikash dhe objektivash strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate, sipas urdhërit nr. 139, datë 1.7.2010, të kryeministrit, “ Për zbatimin e procesit të monitorimit të Strategjive Sektoriale e Ndërsektoriale”

Në vazhdim të punës dhe përpjekjeve të MMSR-së për krijimin e një mekanizmi efektiv të monitorimit dhe vlerësimit të progresit në nivel kombëtar të Planit Kombëtar të Veprimit, si dhe për bashkëveprimin ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve/ zyrave qeveritare për Romët; MMSR do të riaktivizojë sistemin elektronik online “ROMALB” si një sistem në të cilin do të hidhen dhe përditësohen të dhëna për treguesit e Planit të Veprimit 2016-2020 dhe që do të kontribuojnë në: i. Lehtësimin e veprimtarisë në mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave në kohë reale për nivele të ndryshme ndërhyrjesh në komunitetet Rome dhe Egjiptiane; ii. Monitorimin dhe analizën e të dhënave në nivel kombëtar të indikatorëve të Planit të Veprimit;. iii. Përmirësimin e cilësisë së raporteve të gjeneruara nga MMSR si dhe; iv. Kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave për Romët dhe Egjiptianët me qëllim monitorimin e ndërhyrjeve dhe vlerësimin e situatës për përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre.

MMSR do të marrë masat për trajnimin dhe ofrimin e asistencës teknike të vazhdueshme të përdoruesve të sistemit elektronik “ROMALB”, për regjistrimin e të dhënave të treguesve të monitorimit, përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të këtij sistemi. Në funksion të përdorimit me efektivitet të sistemit “ROMALB”, MMSR në cilësinë e koordinatorit të implementimit dhe raportimit të këtij plani veprimi do të bashkëpunojë dhe bashkërendojë punën, përveçse me të gjitha ministrinë e linjës, edhe me institucione të tjera të pavarura, si dhe do të propozojë masa për eficientësinë e sistemit elektronik dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe e Rinisë ka një rol koordinues dhe ndërkohë Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore brenda kësaj Ministrie monitoron zbatimin e Planit të Veprimit ndërsektorial dhe harton raportet e progresit. Pas një monitorimi dhe vlerësimi të progresit gjatë dy viteve të para të zbatimit të këtij Plani , MMSR do të bëjë rishikimin dhe përditësimin e masave të Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve , duke patur parasysh edhe planifikimet buxhetore deri në vitin 2020. Për periudhën 2016-2020, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e kësaj Drejtorie, në mënyrë që të koordinohet sa më mirë zhvillimi i politikave dhe zbatimi jo vetëm i integritit të Romëve dhe Egjiptianëve, por gjithashtu edhe nxitja e përfshirjes sociale në nivele më të larta.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë do të lehtësojë gjithashtu koordinimin me organizatat



ndërkombëtare, të cilat promovojnë integrimin e romëve dhe egjiptianëve përmes programeve të tyre. Një grup pune sektorial për përfshirjen sociale, do të japë informacion të vazhdueshëm mbi statusin dhe situatat e emergjencës në lidhje me romët dhe egjiptianët. Plani i Veprimit parashikon se këto takime duhet të mbahen çdo gjashtë muaj, duke kryer ndërkohë vizita në terren në njësitë e qeverisjes vendore.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit Kombëtar të Veprimit për integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian 2016-2020, do të jetë seti i indikatorëve të Monitorimit sipas tabelës në Aneksin 2.

Roli i shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në zbatimin e Planit të Veprimit

Plani i Veprimit identifikon organet shtetërore që janë përgjegjëse për zbatimin e secilit prej aktiviteteve, por një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve luajnë edhe grupet e tjera të interesit, të cilat lidhin institucionet me komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe financojnë ndërhyrjet e synuara në situatat e emergjencës ose në zonat emergjente. Organizatat e shoqërisë civile rome dhe egjiptiane si dhe ato që përfaqësojnë interesat e tyre janë identifikuar veçanërisht si partnerë kyç për të siguruar që shërbimet publike të arrijnë deri te komunitetet më vulnerabël. Gjatë periudhës në vijim, qeveria do të vazhdojë të mbështetet në ndihmën që ofrojnë për furnizimin dhe monitorimin e shërbimeve sociale, të kujdesit shëndetësor dhe të arsimimit, për lehtësimin e regjistrimit në gjendjen civile, identifikimin e situatave të emergjencës për strehim dhe bashkëpunimin në fusha të tjera.

Komuniteti ndërkombëtar ka kontribuar gjithashtu në zbatimin e Planit të Veprimit duke promovuar shembujt e praktikës së mirë nga Shqipëria dhe rajoni, si dhe duke (bashkë) financuar disa prej veprimtarive. Për të lehtësuar këtë proces, qeveria ka identifikuar veprimtaritë specifike të Planit të Veprimit që do të përmirësonin statusin e romëve dhe egjiptianëve, por ka hendeqe financiare. Në raste të tjera, qeveria ka caktuar financimin publik, por financimet shpesh nga donatorët mund të rrisin shkallën ose të përmirësojnë cilësinë e veprimtarive të caktuara.

Për të garantuar mbështetje të koordinuar ndaj komuniteteve rome dhe egjiptiane, qeveria fton grupet e interesit nga shoqëria civile si dhe ato ndërkombëtare që të përfshijnë gjithmonë ministrinë përkatëse të linjës në zbatimin e veprimtarive. Kjo qasje do të ndihmojë në koordinimin e përpjekjeve të qeverisë me përpjekjet e grupeve të tjera të interesit, do të ndihmojë në shmangien e mbivendosjes së burimeve të disponueshme dhe në garantimin që këto burime të përdoren në mënyrën më efikase të mundshme.

Roli i bashkive në zbatim



Bashkitë gjenerojnë burime dhe kapacitete të rëndësishme për zbatimin e aktiviteteve të nxitjes së integritimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Deri tani, ka disa bashki që kanë hartuar planet e tyre të veprimit në këtë fushë, dhe ku kanë caktuar prioritete të indentifikuara në bashkëpunim me popullsinë Rome dhe Egjiptjane. Nga ana tjetër, vetë bashkitë mund të zgjedhin që të hartojnë Plane Lokale Veprimi per Përfshirjen Sociale ose Mbrojtjen Sociale, ku integrimi i Romëve dhe Egjiptianëve të jetë objektivi kryesor, por edhe grupe të tjera mund të përfshihen në të.

Gjithashtu, Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e masave të Planit Kombëtar të Veprimit në të gjithë sektorët. Në sajë të rritjes së përgjegjësive të pushtetit vendor bazuar në reformat e Decentralizimit, dhe Administrimit Territorial, ministrinë parashikojnë një bashkëpunim më të ngushtë me Bashkitë për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit.



Treguesit e monitorimit

Nr	Përshkrimi i Treguesve	Baseline/2013	Synimi 2017	Synimi 2020
	Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të lindur dhe të identifikuar si të paregjistruar	267	20% me shume	40% me shume
	Numri i romëve dhe egjiptianëve të informuar rreth procedurave të regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit,	5000	30% me shume	50% me shume
	Numri i djemve dhe vajzave romë dhe egjiptiane të regjistruar dhe që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin e detyruar.	3433 nxenes R&E	10 % me shume	20% me shume
	Numri i romëve dhe egjiptianëve që punojnë si edukatorë në arsimin parashkollor dhe i atyre që punojnë si mësues.	93 mesues R&E	5 % me shume	10% me shume
	Numri i të rejave dhe të rinjve romë dhe egjiptianë të regjistruar në nivele të ndryshme universitare në universitete publike nëpërmjet kuotave të vecanta.	26 studente R&E	5 % me shume	10% me shume
	Numri i romëve dhe egjiptianëve të pajisur me kartela të përgjithshme shëndetësore falas.	3,368 persona R&E	20% me shume	50% me shume
	Numri i nënave romë dhe egjiptiane që marrin paketën për kujdesin e foshnjave dhe nënave.	300	10% me shume	20% me shume
	Numri i romëve dhe egjiptianëve (meshkuj dhe femra) që përfshihen në PNP	146 persona R&E	5 % me shume	10% me shume
	Numri i romëve dhe egjiptianëve (meshkuj dhe femra), të cilët përfundojnë kurset e formimit profesional.	250 persona R&E	5 % me shume	10% me shume
	Numri i individëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë ndihmë ekonomike.	8000 persona	6 % me shume	15% me shume
	Numri i romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë nga qendrat rezidenciale.	235	10% me shume	25% me shume
	Numri i familjeve romë dhe egjiptiane që përfitojnë ndihmë ligjore falas për çështjet gjyqësore që kanë të bëjnë me procesin e legalizimit		300	600
	Përfundimi i hartëzimit të vendbanimeve informale të romëve dhe egjiptianëve, përfshirë llogaritjen e kostove që nevojiten për urbanizimin.			Harta e perfunduar





VIII

Burimet Finanziare



VIII – BURIMET FINANCIARE

Plani i Veprimit përfshin një buxhet për zbatimin e çdo veprimtarie. Në varësi të llojit të veprimtarisë, Plani i Veprimit specifikon:

1. Financimin nga qeveria për masat që kanë si objekt të qartë romët dhe egjiptianët ose që vijnë nga buxheti i përgjithshëm dhe kontribuojnë në përpjekjet për integrimin.
2. Financimi nga donatorët për kostot që nuk mund të mbulohen nga buxheti i qeverisë. Ky financim mund të kanalizohet përmes organeve shtetërore ose organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbimet në fushën e caktuar.
3. Kombinimi i financimit nga qeveria dhe financimit nga donatorët.
4. Asnjë kosto – kur nuk nevojitet financim shtesë për zbatimin e veprimtarive ose kjo gjë mund të arrihet duke përdorur burimet ekzistuese (të përgjithshme) të qeverisë.


Në buxhetin e Planit të Veprimit nuk janë përfshirë zërat e mëposhtëm:

1. Pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve në masat integruese (p.sh. mjekimet që ofrohen edhe për romët dhe egjiptianët që bëhen pjesë e sistemit shëndetësor të përgjithshëm, kostoja e strehimit social të përdorur nga romët dhe egjiptianët midis të tjerëve, kostot e lëshimit të kartave të identitetit për romët dhe egjiptianët, ndihma ekonomike etj.). Vetëm në rastet kur programet e përgjithshme janë reformuar ose përmirësuar për të mundësuar një aksesim më të mirë për romët dhe egjiptianët (duke përfshirë programet e nxitjes së punësimit, AFP-në, bursat për AFP-në, transportin në shkollë dhe programin “Shansi i Dytë”, pjesa proporcionale e këtij buxheti është përfshirë në bazë të numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë dhe kjo është shënuar në matricë.
2. Nuk janë përfshirë gjithashtu buxhetet e bashkive, sepse ato do të pasqyrohen në Planet Lokale të Veprimit për romët dhe egjiptianët (ndërsa plani kombëtar fokusohet në burimet dhe përgjegjësitë kombëtare). Megjithatë, në Planin e Veprimit janë përfshirë fondet e ministrive që u akordohen bashkive (p.sh. nëpërmjet granteve të vogla në fushën e strehimit, apo ndihma ekonomike etj.).
3. Aktivitetet e përkrahura në Matricën e Planit , që shoqërohen me shënimin “Pa Kosto”, janë aktivitete që kryhen nga strukturat shtetërore dhe janë pjesë e detyrave funksionale të nënpunësve të institucioneve.

Qëllimi i këtyre udhëzimeve ishte të paraqisnin vlera reale buxheti dhe të siguronin përfshirjen e burimeve përkatëse. Llogaritja e fondeve të nevojshme u bë në bazë të numrit të përlogaritur të përfituesve (me rritje shtesë gjatë viteve) dhe të kostos mesatare të mallrave ose shërbimeve. **Shtojca Nr. 1 me titull: “Përshkrim narrativ i parashikimit të buxhetit për Planin e Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve”** përmban shumën indikative për të mbuluar nevojat e sektorit si dhe kostimin e cdo mase mbi baza vjetore dhe arsyetimin se si janë bërë përlogaritjet duke ndarë gjithashtu se sa mbulohet financimi i dokumentit politik nga buxheti i shtetit dhe sa nga donatorët, si dhe cilat janë boshllëqet e financimit për secilin sektor. Gjithashtu në tabelën e mëposhtme janë shifrat e financimit të Planit të Veprimit për sektor (përfshirë burimet nga shteti dhe donatorët, dhe totali për të gjashtë vitet).

Sektori	Totali i Buxhetit (Lek)	Buxheti i Shtetit (Lek)	Buxheti i Donatorit (Lek)
Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë	309,266,460	69,786,460	239,480,000
Arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor	2,974,769,959	1,790,477,098	1,184,292,861
Punësimi dhe AFP-ja	1,086,456,899	380,506,899	705,950,000
Kujdesi shëndetësor	584,232,400	428,432,400	155,800,000
Strehimi dhe integrimi urban	1,533,046,979	1,163,946,979	370,100,000
Mbrojtja sociale	1,250,585,551	486,215,551	794,370,000
Koordinimi dhe monitorimi i politikave	54,256,920	19,856,920	34,400,000
TOTALI	7,792,615,168	4,339,222,307	3,484,392,861

Raporti në Euro i Buxhetit të Shtetit me atë të Donatorëve





IX

Matrica e Planit Kombëtar të Veprimit



IX – MATRICA E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

Drafti i Planit Kombëtar të Veprimit për integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020



Fusha e politikës: AKSES I BARABARTË NË REGJISTRIMIN CIVIL DHE NË DREJTËSI

Qëllimi strategjik: Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët.

Aktivitetet	Treguesit	Baza e referimit	Burimi i të dhënave	Organi përgjegjës	Monitorimi /raportimi	Strategjitë me qëllime të përbashkëta	Afati kohor	Financimi		
								Preventivi i kostove	Burimet e mundshme	
